



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gjiçane Belediyesi

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4, të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 20, paragrafi 1 dhe paragrafi 3, pika 3.3 e Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas Kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjiçane, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 101/2016 të datës 11.05.2016 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa 01.Nr.113/2016 të datës 23.05.2016, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me datë më 31.05.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës

I.

Kuvendi i Komunës së Gjiçanit Aprovon kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës - Dega në Gjiçane, për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës për nevoja të Xhamisë në Lagjen e Balcit në Gjiçane.

II.

Lejohet shfrytëzimi i një pjese të sipërfaqes nga ngastrat kadastrale:

- P-70403013-04060-0, te vendi i quajtur “Ruga Kosovës”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 52 m² , shfrytëzimi aktual i parcelës – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë e pakategorizuar, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës – Rrugët, sipërfaqja për dhënien në shfrytëzim 35 m²,
- P-70403013-04777-0, te vendi i quajtur “Ruga Kosovës”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 3354 m² , shfrytëzimi aktual i parcelës – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë e pakategorizuar, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës – Rrugët, sipërfaqja për dhënien në shfrytëzim 28 m², dhe
- P-70403013-04778-0, te vendi i quajtur “Ruga Kosovës”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 1541 m² , shfrytëzimi aktual i parcelës – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë e pakategorizuar, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës – Rrugët, sipërfaqja për dhënien në shfrytëzim 94 m².

Sipërfaqja e tërësishme për dhënien në shfrytëzim nga këto tri ngastrat kadastrale është : 157 m²

III.

Sipërfaqja prej 157 m² ipet në shfrytëzim pa kompensim dhe ka dedikimin për nevoja të Xhamisë së Balecit e cila do të shfrytëzohet nga ana e komunitetit fetar të cilët i zhvillojnë aktivitetet fetare në këtë xhami.

IV.

Afati i shfrytëzimit të kësaj sipërfaqe është 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me kusht që shfrytëzimi i të njejtës nuk bie në kundërshtim me Planet Hapsinore dhe Urbanistike për këtë zonë të qytetit.

V.

Obligohet shfrytëzuesi i kësaj hapsire që të njejtën ta shfrytëzon dhe ta mirëmbajë si nikoqir i mirë me dedikimin për nevoja të xhamisë për zhvillimin e aktiviteteve fetare.

VI

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta bënë parcelimin e sipërfaqeve të dedikuara për xhami dhe njësinë e re kadastrale të krijuar pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjilan.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Nr.01. 016-52215

Gjilan, më 31.05.2016

Kryesuese e Kuvendit

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/